

LegalNews

Shkurt 2020
February 2020



I. Rregullore për Reklamimin e Shërbimeve Financiare

Më 30 janar 2020, Banka Qendrore e Kosovës (më tej: BQK) miratoi Rregulloren për Reklamimin e Shërbimeve Financiare (më tej: "Rregullorja"), e cila është e zbatueshme për të gjitha bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare.

Rregullorja cakton kushtet e përgjithshme dhe specifike për reklamimin e shërbimeve financiare, detyrimet dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve financiare në lidhje me mesazhet reklamuese dhe çështje tjera të ndërlidhura me reklamim.

Shërbimet financiare duhet të reklamohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për klientët, ndërsa ofruesit e shërbimeve duhet tu përmbahen në çdo kohë 5 parimeve thelbësore të mëposhtme:

- i. Identifikimi i qartë i ofruesit të shërbimeve financiare;
- ii. Vërtetësia e informacionit në mesazhin reklamues;
- iii. Transparenca e informacionit në mesazhin reklamues;
- iv. Harmonizimi i informacionit në mesazhin reklamues;
- v. Përshtatshmëria e përmbajtjes dhe respektimi i etikës profesionale.

Rregullorja parasheh kushte specifike për reklamimin në mediat elektronike dhe të shkruara, reklamimin në terren, reklamimin online/virtual, reklamimin e brendshëm, reklamimin e drejtpërdrejtë si dhe përmbajtjen e mesazhit reklamues.

I. Regulation on Financial Services Advertising

On 30th of January 2020, the Central Bank of Kosovo (hereafter: CBK) approved the Regulation on Financial Service Advertising (hereafter: the "Regulation") which is applicable to all banks, microfinancial institutions and non-banking financial institutions.

The Regulation sets out the general and specific conditions for the advertisement of financial services, rights and obligation of a service provider in relation to advertising messaging as well as other matters related to advertising.

Financial services shall be advertised to the clients in clear and concise manner, whereas the service provider shall at all time adhere to the following 5 core principles in mind:

- i. Clear identification of the financial service provider;
- ii. Authenticity of the information in the advertising message;
- iii. Transparency of information in the advertising message;
- iv. Harmonization of information in the advertising message;
- v. Appropriateness of the content and respect of professional ethic.

The Regulation contains specific conditions regarding advertising in electronic and print media, advertising in terrain, online/virtual advertising, internal advertising, direct advertising as well as the content of advertising messages.

Tutje, ofruesi i shërbimeve financiare ka për obligim të sigurohet se kontrata e lidhur me transmetuesin e mesazhit reklamues është e qartë dhe saktësisht përcakton detyrimin e palëve kontraktuese në mënyrë që të sigurohet respektimi i dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e ofruesit.

Shkeljet eventuale të dispozitave të Rregullores janë subjekt i masave përmirësuese, ndëshkimeve administrative dhe dënimeve civile, siç përcaktohet në ligjin në fuqi. Rregullorja ka hyrë në fuqi më 14 shkurt 2020.

II. Rregullore për Qeverisjen Korporative të Siguruesve

Më 30 janar 2020, Banka Qendrore e Kosovës, miratoi Rregulloren për Qeverisjen Korporative të Siguruesve (më tej: "Rregullorja"). Me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit në sektorin e sigurimeve, BQK miratoi këtë Rregullore e cila cakton kriteret/kërkesat minimale për Aksionarët, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë, sa i përket përgjegjësisë të tyre në qeverisjen korporative të siguruesve.

Sipas kësaj Rregulloreje, Bordi i Drejtorëve, i cili emërohet në pajtim me Ligjin për Sigurime, duhet të themelojë komitetet si në vijim:

- i. Komitetin e Auditimit,
- ii. Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut, dhe
- iii. Komitetin për Menaxhimin e Investimeve.

Further, the financial service provider has an obligation to ensure that the contract concluded with the message broadcaster clearly and accurately specifies the obligations of the contracting parties in order to ensure compliance with the provisions of this Regulation by the provider.

Eventual breach of the provisions contained in the Regulation shall be subject to remedial measures, administrative penalties and civil penalties as set forth in the applicable legislation. The Regulation has entered into force on 14th of February 2020.

II. Regulation on Corporate Governance of Insurers

On 30th of January 2020, the Central Bank of Kosovo approved the Regulation on Corporate Governance of Insurers (hereafter: the "Regulation"). With the intention of preserving the sustainability and stability of the insurer sector, CBK has approved this Regulation, which sets out the criteria for Shareholders, Board of Directors and Senior Managers regarding their responsibilities in insurers' corporate governance.

According to the Regulation, the Board of Directors, which is appointed as per the Law on Insurances, shall establish the following committees:

- i. Audit Committee,
- ii. Risk Management Committee, and
- iii. Investment Management Committee.

Vlen të përmendet se këto detyrime nuk aplikohen ndaj degëve të siguruesve të jashtëm, për aq sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në zbatohen me legjislacionin sipas të cilit siguruesi i jashtëm është i licencuar në shtetin amë.

Përveç themelimit të komiteteve, Bordi po ashtu ka përgjegjësi të emëroj Menaxhmentin e Lartë të Siguruesit. Bordi i Drejtorëve duhet poashtu të miratojë një politikë të kompensimit për Menaxhmentin e Lartë, punonjësit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve.

Rregullorja parasheh krijimin e "funksionit të pajtueshmërisë" që do të ketë përgjegjësi sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe rregulloret. Në këtë drejtim, Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se funksioni i pajtueshmërisë ka autorizimet e nevojshme për të kryer funksionin e tij dhe se është i pajisur me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për identifikimin efikas të rrezikut të pajtueshmërisë. Udhëheqësi i funksionit të pajtueshmërisë zgjedhet nga Bordi i Drejtorëve dhe aprovohet nga BQK.

Për më tepër, siguruesit duhet të krijojnë një funksion efektiv për menaxhimin e rrezikut, që ndihmon në:

- i. Identifikimin, vlerësimin, monitorimin, zvogëlimin dhe raportimin në kohë të duhur për rreziqet kryesore; dhe
- ii. Promovimin dhe ruajtjen e një kulture të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut.

Rregullorja ka hyrë në fuqi më 14 shkurt 2020.

It is worth mentioning that such requirements are not applied to the branches of foreign insurers, insofar as comparable and acceptable requirements to the CBK are applied by legislation, under which the foreigner insurer is licenced in home country.

In addition to the establishment of the committees, the Board also has a responsibility to appoint the Senior Management of the Insurer. The Board of Directors shall also approve a compensation policy for the Senior Management, employees and for insurance intermediaries.

The Regulation foresees the establishment of a "compliance function", which shall ensure compliance with the applicable legislation and regulations. In this respect, the Board of Directors shall ensure that the compliance function has the necessary authority to perform its function and is equipped with sufficient human and financial resources for the effective identification of compliance risk. The head of compliance function is elected by the Board of Directors and approved by the CBK.

In addition to the above, insurers shall establish an effective function for risk management, who shall assist the insurer in:

- i. Timely identification, evaluation, monitoring, mitigation and reporting of major risks; and
- ii. Promoting and maintaining a sound risk management culture.

The Regulation has entered into force on 14 th February 2020.

Deloitte Contacts

Afrore Rudi

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 590 807
E-mail: arudi@deloitteCE.com

Ardian Rexha

Senior Legal Associate | Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 780 430
E-mail: arrexha@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.